

Vendim nr. 229 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 34 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: AGIM MAJA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4771, datë 21.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Agim Maja ka qenë në marrëdhënie pune me detyrë polic zjarrfikës në Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin (*PMNZSH*) të Prefekturës së qarkut Durrës (*Prefektura Durrës*). Marrëdhëniet e punës kanë filluar në datën 03.07.2006, ndërsa me urdhrin nr. 126/1, datë 02.10.2014 të prefektit të qarkut Durrës, kërkuesi është përjashtuar nga

PMNZSH-ja, bazuar në nenin 13, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar (*ligji nr. 8766/2001*), mbi shkakun se pranimi i tij është bërë në kundërshtim me nenin 10, pika 1, shkronja “c”, të këtij ligji.

2. Në datën 24.10.2014 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, Prefekturës Durrës, për ta dëmshpërblyer me 12 paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, me 3 paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit, me 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe për t’i paguar shpërblimin për pushimet vjetore të pakryera. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.7321, datë 12.12.2014, ka shpallur moskompetencën tokësore, duke ia dërguar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 251, datë 27.02.2015, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar palën e paditur t’i paguajë kërkuesit vetëm shpërblimin për pushimet vjetore të pakryera, ndërsa ka rrëzuar padinë për kërkimet e tjera. Sipas asaj gjykate, vetë ligji nr. 8766/2001 ka parashikuar përjashtimin nga shërbimi zjarrfikës të punonjësit të PMNZSH-së në rastin kur pranimi i tij është bërë në kundërshtim me ligjin, prandaj, duke qenë se marrëdhënia e punësimit është rregulluar me ligj të veçantë, është ky ligji i zbatueshëm dhe jo Kodi i Punës, i cili zbatohet vetëm kur ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1620, datë 13.04.2017, ka vendosur lënien në fuqi e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi si ajo. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-4771, datë 21.11.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në të nuk ishin ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49 datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, dhe se pretendimet në rekurs kanë marrë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit.

5. Në datën 17.07.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 05.08.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

6.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar rekursin, megjithëse ai i plotësonte kushtet formale të parashikuara në ligj.

6.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, ndërsa nuk analizon bazueshmërinë ligjore të shkaqeve të rekursit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në rastin në shqyrtim, në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të nisur prej tij. Në këtë situatë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

10. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 21.11.2023, kurse ankimi kushtetues individual është depozituar në shërbimin postar në datën 17.07.2024, pra pas rreth 8 muajve. Së bashku me ankimin kushtetues individual, kërkuesi ka depozituar kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë të kundërshtuar, në të cilin gjendet shënimi se ai (vendimi) është tërhequr në datën 13.05.2024, datë së cilës i referohet kërkuesi në ankim për marrjen dijeni të vendimit.

12. Megjithatë, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për efekt të këtij shqyrtimi, rezulton se sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë, në datën 09.01.2024, ka bërë njoftimin elektronik të vendimit të saj në adresën elektronike të lënë nga përfaqësuesi i zgjedhur nga kërkuesi. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 04.01.2024, datë në të cilën është bërë i disponueshëm për palët.

13. Për sa më lart, Kolegji konstaton se data në të cilën kërkuesi ka marrë vendimin e Gjykatës së Lartë pas kërkesës së tij nuk është argument i mjaftueshëm kushtetues në lidhje me datën efektive të marrjes dijeni të tij, sepse një kërkesë e tillë për t’u njohur dhe për të tërhequr vendimin gjyqësor mund të bëhet në çdo moment nga palët ndërgjyqëse. Gjithashtu, duke qenë se kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë fakt kushtetues për pamundësinë e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e Gjykatës së Lartë të kundërshtuar, nga momenti që ai i është njoftuar përfaqësuesit të tij apo është bërë i disponueshëm për palët, bazuar në standardet e lartpërmendura, Kolegji vëren se data e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual do të konsiderohet ajo e njoftimit elektronikisht të vendimit të Gjykatës së Lartë përfaqësuesit të kërkuesit, pra më 09.01.2024. Ndërkohë, kërkesa është paraqitur në datën 17.07.2024, që do të thotë më shumë se 2 muaj, përtej afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*.

14. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterit *ratione materiae* bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Prandaj, në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.